

Të drejtat tuaja

Your Rights

Keni të drejtë të mos keni braktisje, abuzim, shfrytëzim financiar dhe neglizhim. Nëse ekziston një arsye të besohet se keni përjetuar braktisje, abuzim, shfrytëzim financiar ose neglizhim, keni të drejtën të:

1. Raportoni pranë Departamentit të Shërbimeve Sociale dhe Shëndetësore (DSHS) dhe zbatimit të ligjit e të jepni çdo informacion që besoni se mund të jetë i përshtatshëm për hetimin dhe të identifikoni çdo person që besoni se mund të ketë informacion të përshtatshëm.
2. Të mos keni hakmarrje ndaj jush për raportimin ose bërjen e një raporti të braktisjes, abuzimit, shfrytëzimit financiar ose neglizhimit.
3. Të trajtoheni me dinjitet dhe t'ju drejtohen me gjuhë plot respekt.
4. Të merrni akomodim të arsyeshëm për pa-aftësinë tuaj kur bëhen raportime dhe gjatë hetimeve e procedimeve administrative.
5. Të kërkonte një urdhër që ndalon këdo që ju ka braktisur, abuzuar, shfrytëzuar financiarisht dhe neglizhuar nga qëndrimi në shtëpinë tuaj ose që të ketë kontakte me ju ose që të mund të përdorë paratë ose pasurinë tuaj.
6. Të merrni nga DSHS informacion dhe referime të përshtatshme tek agjenci të tjera që mund të këshillojnë, të hetojnë ose të ndërmarrin veprim.
7. Të informoheni mbi gjendjen e hetimeve, procedimeve, veprimeve të gjykatës dhe rezultateve nga agjencia që është duke trajtuar ndonjë rast në të cilin jeni një viktimë.
8. Të kërkonte referime për këshillim ose ndihmë ligjore për të ndihmuar me planifikimin e sigurisë, hetime ose seanca.
9. Të ankoheni pranë DSHS-së në mënyrë zyrtare ose jozyrtare mbi hetime ose procedime dhe të merrni një përgjigje të shpejtë.

Për të bërë një raport të abuzimit, braktisjes, neglizhimit, vetë-neglizhimit ose shfrytëzimit financiar ose të kërkonte më shumë informacion, telefononi:

1-866-EndHarm (1-866-363-4276)

Mundësia e përdorimit të Zërit/TTY 1-800-737-7931

Do të transferoheni tek Zyra vendore e Marrjes e APS-së për të bërë një raport ose për të kërkuar informacion.

Informacioni i kontaktit vendor: